



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.73/7 prot.

Datë 27.01.2026

V E N D I M
Nr.147/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.01.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-68926-11-14-2025, me objekt: “LOTI 1: Blerje lende djegese per ngrohje pellet -briket, për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan”, me fond limit 31,011,552.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 18.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK me NIPT K01529003M dhe adresë: Rruga "Muhamet Gjolllesha", 71/3, Kati 1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021, “*Për miratimin e rregullave ‘Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik’*”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020, datë 5.11.2020, “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30, të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 17.11.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-68926-11-14-2025, me objekt: “LOTI 1: Blerje lende djegese per ngrohje pellet -briket, për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan”, me fond limit 31,011,552.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 18.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

II.2. Në datën 18.12.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 05.01.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

PISHA	29,927,232 lekë	Kualifikuar
SULLOLLARI-KLIMA	15,995,888.64 lekë	Skualifikuar

II.4. Në datën 08.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5. Në datën 12.01.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6246 dhe me nr. protokoli 73/2026, datë 12.01.2026, e operatorit ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 73/1, datë 12.01.2026.

II.7. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, autoriteti kontraktor, me shkresën nr. 3808/19 prot., datë 21.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 73/2 prot., datë 21.01.2026, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin nr. 07/2026 prot., datë 21.01.2026 të KSHA në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK. Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim të shqyrtimit ka vendosur refuzimin e saj.

II.8.Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor, me shkresën nr. 3808/19 prot., datë 21.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 73/3 prot., datë 23.01.2026, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin nr. 07/2026 prot., datë 21.01.2026 të KSHA në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, procesverbalin e komisionit të vlerësimit të ofertave, si dhe dokumentacionin e plotë të paraqitur nga ky operator ekonomik për të justifikuar ofertën e tij ekonomike, e cila ka rezultuar anomalisht e ulët.

II.9. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor, me shkresën nr. 297/1 prot., datë 22.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 73/4prot., datë 26.01.2026, me objekt “*Kthim përgjigje*” ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion drejtuar intitucionit përfitues “*Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan*, ku e informon në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK e më konkretisht citon: “... jemi në pritje të vendimit të KPP-së për vazhdimin e hapave të mëtejshëm proceduralë.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Sulollari-Klima” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: “*“Autoriteti kontraktor në datën 24.12.2025 i ka kërkuar operatorit ekonomik nëpërmjet rubrikës “kërkesa” në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), të dorëzojë argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.*

2. *Operatori ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, në datën 29.12.2025, ka dorëzuar ne protkollin e OBP dokumentin e emërtuar “Sqarim Oferten Anomalisht te Ulet” shoqeruar me faturat tatimore elektronike gjithsej 8 flete.*

3. *Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

4. *Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:*

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

5. Në nenin 93 “Oferta anomalisht e ulët” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë. 2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për: a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës; c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës; d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore. 3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj, duke marrë në konsideratë elementet e përmendura në pikën 2 të këtij neni. Autoritetet ose entet kontraktore e refuzojnë ofertën kur konstatojnë se oferta është anomalisht e ulët, sepse nuk pajtohet me detyrimet e zbatueshme nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës e të akteve të tjera. 4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

6. Në nenin 82 pika 4 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “4. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: - Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur; - Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga

ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP së. Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.”.

7. Në pikën 3 të VKM nr. 113, datë 1.3.2023 “Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 40 000 (dyzet mijë) lekë.

2. Paga bazë minimale mujore jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës.

3. Paga bazë minimale orare të jetë 229,9 (dyqind e njëzet e nëntë pikë nëntë) lekë.

4. Shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë.

5. Vendimi nr. 604, datë 14.9.2022, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, shfuqizohet. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2023.”

8. Në nenin 10 “Masa e kontributeve” të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“Kontributi që paguhet për sigurimet shoqërore në fondet e sigurimeve për sëmundje, barrë lindje dhe pensione do të jetë:

a) për punëdhënësit 13,8 për qind e shumës bruto të listëpagesave;

b) për personin e punësuar 9.5 për qind e pagesës së tij totale (bruto). Kontributi llogaritet dhe paguhet mbi pagën bruto, brenda kufijve të pagës minimale në shkallë vendi dhe pagës maksimale për efekt kontributi për sigurimet shoqërore, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, e cila është në fuqi në datën 31.12.2014.

Pas datës 01.01.2015, paga maksimale për efekt kontributi indeksuhet në të njëjtën kohë dhe në atë masë që indeksuhet paga minimale në shkallë vendi. Kontributi minimal për personin e punësuar, punëdhënësin dhe të vetëpunësuarin është i barabartë dhe llogaritet mbi bazën e pagës minimale në shkallë vendi. Paga maksimale, për efekt kontributi, rritet me të njëjtën masë dhe në të njëjtën kohë me masën që rritet paga minimale në shkallë vendi. Personat e vetëpunësuar në bujqësi paguajnë kontribut për pension dhe barrë lindje, të llogaritur mbi pagën minimale në shkallë vendi. Pagesa e kontributit bëhet çdo tremujor. Personat e punësuar me profesion në fushën e teknologjisë së informacionit (IT) dhe të regjistruar në subjektet me aktivitet kryesor në fushën e teknologjisë së informacionit, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas ligjit nr. 58/2022, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi për këtë kategori, paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore në nivelin e pagës minimale mujore në shkallë vendi, me miratimin paraprak të punëmarrësit, të evidentuar në kontratën e punës, pavarësisht pagës bruto të deklaruar.”.

9. Në nenin 8 “Masa e kontributit” të ligjit nr.10383, datë 24.2.2011 “PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, i

ndryshuar, përcaktohet se: “1. Masa e kontributit të sigurimit të detyruar shëndetësor është 3,4 për qind e bazës për llogaritjen e kontributeve sipas pikave 1, 3 dhe 4 të nenit 7 të këtij ligji. 2. Për të punësuarit, kontributet paguhen, në masën 50 për qind nga punëdhënësi dhe në masën 50 për qind nga i punësuari.”.

10. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni i Vleresimit të Ofertave konstaton, se oferta ekonomike në vlerën prej 15,995,888.64 lekë pa TVSH, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar rezulton anomalisht e ulët. KVO thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të lex specialis. Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” KVO gjykon, se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, KVO gjykon, se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për t’i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën.

11. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu, është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë mundësinë e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur.

12. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. KVO gjykon, se nga interpretimi teologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë

me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KVO gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: • rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; • rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; • humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. 13. Gjithashtu, KVO thekson se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlogaritjes të parashikuar në ligj.

14. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë, KVO gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe mundësinë për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

15. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik, për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, Komisioni i Vleresimit të Ofertave konstaton se, struktura e kostos e argumentuar për artikullin objekt prokurimi është teresisht evazive pa asnjë analize të detajuar: Përlogaritja përbëhet nga elementët si në vijim: • “Kosto e lëndës së parë (Pellet 433,728 kg, cmim per kg 36.88 leke pa Tvsh;

16. Nderkohe, mungojnë elementet e kostos për:

1) vleren e ores se punes per punonjesit qe nevojiten per kryerjen e magazinimit dhe furnizimit te mallit,

2) Koston e Transportit,

17. Pra, ne strukturen e kostos se paraqitur nga operatori ekonomik mungojne keto element. Gjithashtu, lidhur me argumentimin e kostos së cmimit të blerjes së Pelletit, operatori ka paraqitur faturat tatimore elektronike leshuar nga shitesi: “Eco Energy System” Sh.p.k, si ne vijim:

1) Fatura Nr.15, date 07.11.2025, per Sasin 5.490 kg, me cmimin 20 leke pa Tvsh per kg;

2) Fatura Nr.16, date 08.11.2025, per Sasin 6.000 kg, me cmimin 20 leke pa Tvsh per kg;

3) Fatura Nr.25, date 28.11.2025, per Sasin 6.000 kg, me cmimin 20 leke pa Tvsh per kg;

4) Fatura Nr.10, date 28.01.2024, per Sasin 6.000 kg, me cmimin 20 leke pa Tvsh per kg;

5) Fatura Nr.11, date 31.01.2024, per Sasin 5.850 kg, me cmimin 20 leke pa Tvsh per kg;

Total Kilogram: 29,340

18. KVO gjykon se dokumentacioni provues i paraqitur nga operatori ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK nuk vërteton me faturat e paraqitura sasin minimale të kërkuar në DST prej

433,728 kg por 29,340 kilogram, duke mos argumentuar dot me dokumentacion sasin totale te kerkuar.

19. Nisur nga sa më sipër KVO gjykon se operatori ekonomik ka dështuar në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, pasi njëri nga elementët e kostos së përlllogaritur prej tij dhe konkretisht paga orare minimale rezulton e pa përcaktuar sipas pikës 3 të VKM nr. 113, datë 1.3.2023 “Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi”.

20. Për më tepër, referuar nenit 93 pika 2/ç, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ku shprehet qartë se nuk mjafton vetëm të vërtetosh kostot e elementëve të ofertës por duhet edhe të jesh në përputhje me detyrimet që rrjedhin në fushën sociale dhe atë të punës, referuar kësaj operatori ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK nuk ka përlllogaritur pagën orarë ne analizën e ofertës anomalisht të ulët por vetem ka përlllogaritur:

Sasi Cmim Vlera

Blerje 433,728 20 8,674,560

Shitje 433,728 36.88 15,995,888.64

Diferenca 7,321,328.64

21. Pra, përlllogaritja duke mos përfshire te gjithë elementet e kostos, është në kundërshtim me VKM nr. 113, datë 1.3.2023 “Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi”. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e referuara me sipër, Komisioni i Vleresimit të Ofertave gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik, oferta e të cilit në zbatim të formulës së përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, nuk është arritur që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Rrjedhimisht Komisioni i Vleresimit të Ofertave gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, nuk është paraqitur argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në përputhje me nenin 93 pika 2 të LPP-së, ndaj oferta e këtij operatori skualifikohet nga ana e autoritetit kontraktor.

22. Ne nje rast te ngjashem, Komisioni i Prokurimit Publik, si organi qe merr vendime administrativisht perfundimtare, me ane te Vendimit Nr. 95/2024, date 26.01.2024, ka arsyetuar se: “Barra e provës për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar si e tillë. KPP ka theksuar se shpjegimet e operatorit ekonomik duhet të plotësojnë katër kushtet kumulative të parashikuara në nenin 93, pika 2, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe se mosplotësimi i qoftë edhe njërit prej këtyre kushteve sjell dështimin e argumentimit të ofertës anomalisht të ulët. Në këtë vendim, KPP ka gjykuar se deklarimi i pagave orare më të ulëta se paga minimale e përcaktuar në VKM nr. 113/2023, si dhe mungesa e një analize të plotë dhe të verifikueshme të kostos së punës, përbën mospërputhje me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën sociale dhe të punës, referuar nenit 93, pika 2/ç të LPP-së. Për rrjedhojë, KPP ka konkluduar se operatori ekonomik ka dështuar në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, pasi nuk ka krijuar bindjen se oferta është e rregullt në të gjitha elementet e saj dhe garanton realizimin e suksesshëm të kontratës.” Ky arsyetim gjen zbatim të plotë edhe në rastin konkret, pasi operatori ekonomik nuk ka paraqitur një analizë të detajuar dhe të verifikueshme të kostos së punës dhe

nuk ka provuar përputhshmërinë me pagën minimale orare të përcaktuar në VKM nr. 113/2023, duke dështuar kështu në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

23. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, si organi që merr vendime administrativisht perfundimtare, me ane të Vendimit Nr. 1650/2024, datë 20.11.2024, ka arsyetuar se: “Siç u përmend më lart, përveç argumentimit në formën e një narrative, ku shpjegon çmimin e ofertuar prej tij dhe elementet favorizuese që disponon të shoqëruara me dokumente provuese, operatori ekonomik “BAULED” SHPK ka paraqitur edhe analizën e detajuar të kostos në përmbushje të gërmës a) të nenit 93 të LPP-së, ku flitet për anën ekonomike të metodës së ndërtimit dhe paraqitjes së analizës së kostos për të gjitha elementet, duke përfshirë edhe koston e magazinimit, administrative dhe koston e transportit. Pra, operatori ekonomik “BAULED” SHPK, ka detajuar analizën e kostos në trajtë analitike, duke e argumentuar me prova dhe fakte dhe ka justifikuar çmimin e ofertuar për çdo zë.”

Referuar rastit të operatorit ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se oferta e dorëzuar nuk përmbush kërkesat për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët sipas nenit 93 të LPP-së. Operatorit ekonomik i mungon një analizë e detajuar dhe analitike e kostos, ku të pasqyrohen të gjithë elementët përbërës të saj, përfshirë: pagat orare për punonjësit, koston e magazinimit dhe furnizimit të mallit, koston e transportit dhe koston administrative.

Dokumentacioni provues i dorëzuar (faturat për Pellet) vërteton vetëm një pjesë të çmimit të lëndës së parë, ndërsa mungesa totale e detajimit të elementëve të tjerë të kostos bën të pamundur vërtetimin e saktë të ofertës dhe krijimin e bindjes se kontrata mund të realizohet me sukses.

24. Se fundmi, në një rast të ngjashëm, Komisioni i Prokurimit Publik, si organi që merr vendime administrativisht perfundimtare, me ane të Vendimit Nr.848/2021, datë 04.11.2021, ka arsyetuar se: “Gjithashtu operatori ekonomik ka dështuar të provojë me dokumentacion provues shpenzime të tjera shtesë ndër të cilat përfshihen edhe shpenzimet e punonjësve. Operatori ekonomik ankimues ka detyrimin ligjor që të prezantojë me dokumentacion provues katër kushtet kumulative të përcaktuara në nenin 93 pika 2 të lex specialis si dhe mundësinë (në rastet kur ai mund të marrë ndihmë shtetërore) për plotësimin e kushtit të pestë, që do të garantonin realizimin e shërbimit pranë autoritetit kontraktor. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik, oferta e të cilit në zbatim të formulës së përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, apo origjinaliteti i shërbimit të propozuar), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Rrjedhimisht Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik ankimues “Biometric Albania” SHPK, nuk është sjellë argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në përputhje me nenin 93 pika 2 të LPP-së, ndaj oferta e këtij operatori duhet të skualifikohet nga ana e autoritetit kontraktor. Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Biometric Albania” SHPK nuk qëndron.”

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, konstatohet se operatori nuk ka paraqitur dokumentacion provues për shpenzime të tjera të nevojshme, duke përfshirë pagat e punonjësve për kryerjen e magazinimit, shperndarjes dhe furnizimit ne adresat e percaktuara nga autoriteti perfitues i mallit. Për këtë arsye, argumentimi i ofertës anomalisht të ulët nuk konsiderohet i plotë, pasi nuk krijon bindjen se oferta është e rregullt në të gjitha elementet e saj dhe se kontrata mund të realizohet me sukses.

Bazuar në arsyetimin e mësipërm dhe nenin 93 pika 2 të LPP-së, Autoriteti Kontraktor gjykon se oferta e operatorit “Sulollari-Klima” SHPK skualifikohet nga ana e autoritetit kontraktor.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë KPP-së, me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 73/3 prot., datë 23.01.2026, rezulton se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar, se oferta e operatorit ekonomik “Sulollari Klima” SHPK është në kushtet e ofertës anomalisht të ulët. Në këto kushte KVO më datë 24.12.2025, i është drejtuar operatorit ekonomik “Sulollari Klima” SHPK me kërkesë që të paraqesë pranë autoritetit shpjegime, në lidhje me ofertën anomalisht të ulët, të cilat duhet t’i argumentonte dhe dokumentonte edhe me prova shkresore.

III.1.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë KPP-së me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 73/3 prot., datë 23.01.2026, rezulton se në përgjigje të kërkesës së autoritetit kontraktor më datë 29.12.2025, operatori ekonomik “Sulollari Klima” SHPK, ka dorëzuar në zyrën e protokollit të autoritetit kontraktor dokumentin e emërtuar “*Sqarim ofertën anomalisht të ulët*”, shoqëruar me faturat tatimore elektronike, gjithsej 8 fletë, me qëllim justifikimin e ofertës anomalisht të ulët,

III.1.3. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [....]”

III.1.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.1.5. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Sulollari Klima” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se oferta ekonomike në vlerën prej 15,995,888.64 lekë pa TVSH, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të lex specialis. Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP gjykon, se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për t’i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor

zgjdhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë mundësinë e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së, autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. KPP gjykon, se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e furnizimit/shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP thekson se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se; “Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe mundësinë për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.1.6. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Sulollari Klima” SHPK, në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se argumentimi i dhënë prej tij është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik lidhur me argumentimin/sqarimin e ofertës anomalisht të ulët.

Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “Sulollari Klima” SHPK, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues: argumentimin e ofertës në

mënyrë narrative përmes shkresës datë 29.12.2025 me lëndë “Shpjegime/sqarime për ofertën anomalisht të ulët”, ku ka shpjeguar të gjitha elementet e ofertës së paraqitur prej tij dhe duke e justifikuar çmimin e ofertuar bazuar në disa komponentë. Konkretisht ankimuesi ka deklaruar se: “...Shoqeria “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK është një kompani e themeluar në vitin 2000. Kjo kompani gjatë gjithë këtyre viteve ka krijuar një experience të gjatë në tregun e montimeve, ndertimeve, shërbimeve dhe mirëmbajtjeve në fushën e cilën operon. Kompania jone ka lidhur shumë kontrata dhe ka realizuar me sukses shumë punime si me kompani private ashtu dhe me institucione shtetërore. Firma disponon të gjitha kapacitetet ekonomike dhe teknike, stafin dhe makineritë për të realizuar me sukses objektin e “LOTI 1: Blerje lende djegëse për ngrohje pellet -briket, për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan.

a) *Ana ekonomike e procesit të prodhimit dhe e mallrave të ofruara*

Operatori ynë ekonomik disponon fatura blerjeje të drejtpërdrejta nga prodhues/furnitorë vendas, me çmim mesatar 20 lek/kg pa TVSH për pellet, çmim i cili është ndjeshëm më i ulët se mesatarja e tregut për shkak të: • kontratave afatgjata me furnitorë prodhues; • blerjes në sasi të mëdha (volum i lartë); • eliminimit të ndërmjetësve; • uljes së kostove logjistike përmes magazinimit dhe transportit të organizuar nga vetë operatori

	Sasi	Cmim	Vlera
Blerje	433,728	20	8,674,560.00
Shitje	433,728	36.88	15,995,888.64
Diferenca			7,321,328.64

Kjo diferencë çmimi na mundëson të ofrojmë një çmim konkurrues, duke përfshirë të gjitha kostot operative, transportin, magazinimin dhe fitimin e arsyeshëm.

b) *Zgjidhjet teknike dhe kushtet favorizuese të furnizimit*

Operatori ynë ekonomik disponon: • mjete transporti në pronësi; • kaldajat e pelletit në pronësi; • magazina për ruajtjen e pelletit në kushte teknike të përshtatshme; • staf të kualifikuar për menaxhimin e furnizimit dhe shpërndarjes. Këto kushte na lejojnë ulje të ndjeshme të kostove operative, duke shmangur shpenzime shtesë që rëndojnë çmimin final.

c) *Origjinaliteti i furnizimeve të propozuara*

Produkti i ofruar është pellet i certifikuar, i prodhuar nga lëndë drusore sipas standardeve përkatëse dhe i përshtatshëm për përdorim në sisteme ngrohjeje institucionale. Furnizimi realizohet drejtpërdrejt nga burimi, pa ndërhyrje tregtarësh të tretë, çka garanton cilësi konstante dhe çmim të qëndrueshëm

ç) *Pajtuëshmëria me legjislacionin mjedisor, social dhe të punës*

Operatori ekonomik deklaron se: • respekton plotësisht legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit; • zbaton të gjitha detyrimet ligjore në fushën sociale dhe të punës; • punonjësit janë të sigurve dhe të deklaruar sipas legjislacionit shqiptar; • aktiviteti ekonomik nuk përfiton nga praktika që cenojnë konkurrencën apo standardet ligjore.

d) *Ndihma shtetërore*

Operatori ynë ekonomik nuk përfiton asnjë formë ndihme shtetërore, subvencioni apo lehtësimi fiskal që të ndikojë në uljen artificiale të çmimit të ofertës. Çmimi i ofruar është rezultat ekskluziv i avantazheve ekonomike dhe organizative të operatorit.

Përfundim

Oferta jonë është e justifikuar ekonomikisht, teknikisht dhe ligjërish dhe është plotësisht e realizueshme në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit.

Bashkëlidhur këtij justifikimi paraqiten faturat e blerjes së mallit, si provë dokumentare e çmimit të furnizimit”. Gjithashtu, ankimesi ka paraqitur edhe fatura blerje të mallit objekt prokurimi (pelet0, ku evidentohet cmimi i blerjes 20 lekë/kg.

Siç u përmend më lart, përveç argumentimit në formën e një narrative, ku shpjegon çmimin e ofertuar prej tij dhe elementet favorizuese që disponon, operatori ekonomik “Sulollari Klima” SHPK ka paraqitur edhe fatura blerje për të justifikuar çmimin e blerjes për mallin objekt prokurimi Pra, operatori ekonomik ankimesi ka arritur që të argumentojë ofertën anomalisht të ulët, duke krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Rrjedhimisht Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik ankimesi “Sulollari Klima” SHPK, është paraqitur argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në përputhje me nenin 93 pika 2 të LPP-së.

III.1.7. Komisioni gjykon, se një ofertë anomalisht e ulët mund të justifikohet ekonomikisht përmes metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushteve përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik “Sulollari Klima” SHPK janë dorëzuar të gjitha dokumentet provuese mbi metodën e ndërtimit të ofertës ekonomike, mbi të cilën edhe operatori ekonomik ka ofertuar në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe ose ndonjë kusht favorizues, origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, duke argumentuar plotësisht, se pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Argumentimi i dhënë nga operatori ekonomik “Sulollari Klima” SHPK., në rastin konkret krijon bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Akoma më tej, Komisioni sjell në vëmendje faktin, se është detyrim i operatorëve ekonomikë, që në rast të shpalljes fitues, t’i përmbahen zbatimit të kontratës duke ofruar shërbime/punë/mallra me të njëjtën cilësi, të kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe me të njëjtën ofertë ekonomike të propozuar. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të detyrimeve që rrjedhin nga LPP, për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit/punës/shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe

specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet sipas parashikimeve të *lex specialis* për prokurimin publik.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Sulollari Klima” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-68926-11-14-2025, me objekt: “LOTI 1: Blerje lende djegese për ngrohje pellet -briket, për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan”, me fond limit 31,011,552.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 18.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Sulollari-Klima” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

